**VENDIM**
**Nr. 993, datë 9.12.2020**

# PËR MIRATIMIN E TARIFAVE PËR PËRDORIMIN E UJIT, TË UJËRAVE NDËRKUFITARE, PAGESAVE ADMINISTRATIVE TË SHKARKIMIT TË UJËRAVE DHE RIPËRDORIMIT TË TYRE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 48, pika 3, 82 e 92, pikat 1 e 2, të ligjit nr. 111/2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifave për përdorimin e ujit dhe të ujërave ndërkufitare, sipas tabelës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Miratimin e tarifave të shkarkimit të ujërave dhe ripërdorimit të tyre, sipas tabelës nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Tarifat e përdorimit të ujit, të parashikuara në tabelën nr. 1, bashkëlidhur vendimit, janë 0 (zero), kur në kontratën e koncesionit për hidrocentrale, të lidhur nga autoriteti përkatës kontraktor, është parashikuar pagimi i tarifës së koncesionit nga ana e koncesionarit.
4. Tarifat për përdorimin e ujërave ndërkufitare me leje, autorizim apo koncesion janë të njëjta me ato të përcaktuara në tabelën nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
5. Tarifat arkëtohen në emër të Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore dhe derdhen në buxhetin e shtetit. Një kopje e mandatpagesës dorëzohet pranë Zyrës së Administrimit të Basenit Ujor që mbulon basenin përkatës.
6. Vendimi nr. 662, datë 21.9.2016, i Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e tarifave të përdorimit të ujit dhe të shkarkimeve të lëngëta", shfuqizohet.
7. Ngarkohen Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore dhe Zyrat e Administrimit të Baseneve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Erion Braçe**

TABELA NR. 1

| Nr. rend. | Tipat e përdorimit të burimit ujor | | Tarifa e përdorimit |
|---|---|---|---|
| 1 | Miratimi në parim i dhënies me koncesion të përdorimit të burimit ujor sipërfaqësor | për ≤2 l/sek. | 0 |
| | | për >2 l/sek | 0 |
| 2 | Përdorim burimi ujor sipërfaqësor për ujë të pijshëm (sisteme të furnizimit me ujë të popullatës) | për ≤2 l/sek | 0.05 lek/$m^3$ |
| | | për >2 l/sek | 0.05 lek/$m^3$ |
| 3 | Përdorim burimi ujor sipërfaqësor për ujë të ambalazhuar | për prodhim < 150 shishe/orë; përdorim ≤ 1 l/sek) | 4.5 lek/$m^3$ |
| | | për prodhim ≥ 150 shishe/orë; përdorim >1 l/sek). | 5 lek/$m^3$ |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 4 | Përdorim burimi ujor sipërfaqësor për ujitje | për ≤5 ha; ≤5 l/sek. | 300 lek/ha |
| | | për >5 ha; >5 l/sek. | 500 lek/ha |
| 5.1 | Përdorim burimi ujor sipërfaqësor për akuakulturë (në rastin e ujërave të rrjedhshëm) | kur përdorimi është për ≤5 ton/vit; ≤5 l/sek | 1 lek për kg peshk të shitur |
| | | kur përdorimi është për >5 ton/vit; >5l/sek | 1 lek për kg peshk të shitur |
| 5.2 | Përdorim burimi ujor sipërfaqësor për akuakulturë (në rastin e ujërave të qëndrueshëm) | | 1 lek për kg peshk të shitur |
| 6 | Përdorim burimi ujor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjetik | kur përdoruesi është KESH-i | 1% e çmimit të shitur për çdo kW/orë të prodhuar. |
| | | kur përdoruesi është shoqëri private | 2.3% e çmimit të shitur për çdo kW/orë të prodhuar. |
| 7 | Përdorim burimi ujor sipërfaqësor për qëllime industriale dhe teknologjike | | 1.5 lek/$m^3$ |
| 8 | Përdorim burimi ujor për lundrueshmëri | | 0 |
| 9 | Përdorim i ujërave detarë për prodhim energjie elektrike | | 2.3% e çmimit të shitur për çdo kw/orë të prodhuar |
| 10 | Përdorim me leje burimi ujor sipërfaqësor për qëllime të tjera (që nuk përfshihen në përdorimet e tjera) | | Përcaktohet me propozim të AMBU-së me tarifat e përdorimit në rastet e ngjashme dhe miratohet në KKU/KBU. |
| 11 | Përdorim burimi ujor sipërfaqësor për qëllime blegtorale kur shoqërohet me instalime tubacionesh dhe ndërtime objektesh | kur përdorimi është <1 l/sek. | 3 lek/$m^3$ |
| | | kur përdorimi është 1-5 l/sek. | 3 lek/$m^3$ |
| | | kur përdorimi është >5 l/sek. | 3 lek/$m^3$ |
| 12 | Përdorim burimi ujor sipërfaqësor për turizëm, argëtim, lundrim për argëtim. | | 0 |
| 13 | Përdorim burimi ujor sipërfaqësor për kërkime, studime, që kanë për objekt ujin | | 0 |
| 14 | Përdorim burimi ujor sipërfaqësor për kërkime, studime që nuk kanë nuk kanë për objekt ujin | | 0 |
| 15 | Përdorim burimi ujor sipërfaqësor, me autorizim nga institucionet monitoruese të ujërave sipërfaqësorë e nëntokësorë dhe institucionet shkencore, për kërkime, studime, eksplorime që ndikojnë në prishjen e ekuilibrave sasiorë dhe cilësorë të ujërave | | 0 |
| 16 | Përdorim me autorizim burimi ujor sipërfaqësor për qëllime të tjera (që nuk përfshihen në përdorimet e tjera) | | Përcaktohet me propozim të AMBU-së me tarifat e përdorimit në rastet e ngjashme dhe miratohet në KKU/KBU. |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 17 | Miratimi në parim për dhënien me koncesion të përdorimit të burimi ujor nëntokësor | | 0 |
| 18 | Shpimi nëntokësor për nxjerrje uji (pus shpimi) | | 0 |
| 19 | Nxjerrje dhe shfrytëzim i ujit nëntokësor nëpërmjet shpimit për qëllime të ndryshme (që nuk përfshihen në formularët e tjerë) | | Përcaktohet me propozim të AMBU-së me tarifat e përdorimit në rastet e ngjashme dhe miratohet në KKU/KBU. |
| 20 | Përdorim burimi ujor nëntokësor për ujë të pijshëm (sisteme të furnizimit me ujë të popullatës) | kur përdorimi është ≤1 l/sek | 0.1 lek/$m^3$ |
| 20 | Përdorim burimi ujor nëntokësor për ujë të pijshëm (sisteme të furnizimit me ujë të popullatës) | kur përdorimi është >1 l/sek | 0.08 lek/$m^3$ |
| 21 | Përdorim burimi ujor nëntokësor për ujë të ambalazhuar | kur përdorimi është për ≤150 shishe/orë; ≤ 1 l/sek | 11.8 lek/$m^3$ |
| 21 | Përdorim burimi ujor nëntokësor për ujë të ambalazhuar | kur përdorimi është për >151shishe/orë; >1 l/sek | 12.3 lek/$m^3$ |
| 22 | Përdorim burimi ujor nëntokësor për ujitje | kur përdorimi është për ≤5 ha; ≤5 l/sek | 0 |
| 22 | Përdorim burimi ujor nëntokësor për ujitje | kur përdorimi është për >5 ha; >5 l/sek | 0 |
| 23 | Përdorim burimi ujor nëntokësor për akuakulturë | kur përdorimi është për ≤5 ton/vit; ≤5 l/sek | 2 lek për kg peshk të shitur |
| 23 | Përdorim burimi ujor nëntokësor për akuakulturë | kur përdorimi është për >5 ton/vit; >5 l/sek | 2 lek për kg peshk të shitur |
| 24 | Përdorim burimi ujor nëntokësor për prodhim hidroenergjie | kur përdoruesi është kesh-i | 1% e çmimit të shitur për çdo kW/orë të prodhuar |
| 24 | Përdorim burimi ujor nëntokësor për prodhim hidroenergjie | kur përdoruesi është shoqëri private | 2.3% e çmimit të shitur për çdo kW/orë të prodhuar |
| 25 | Përdorim burimi ujor nëntokësor për qëllime industriale | | 4.5 lek/$m^3$ |
| 26 | Përdorim burimi ujor nëntokësor për turizëm dhe argëtim | | 80 lek/$m^3$ |
| 27 | Përdorim burimit ujor kurativ, mineral, termomineral dhe gjeotermal | | 8 lek/vaskë |
| 28 | Shfrytëzim uji nëntokësor për qëllime familjare (jo ujë të pijshëm, sasi < 0.5 l/sek) | | 4.5 lek/$m^3$ |
| 29 | Përdorim burimi ujor nëntokësor për qëllime blegtorale kur shoqërohet me instalime tubacionesh dhe ndërtime objektesh | kur përdorimi është ≤1 l/sek. | 4 lek/$m^3$ |
| 29 | Përdorim burimi ujor nëntokësor për qëllime blegtorale kur shoqërohet me instalime tubacionesh dhe ndërtime objektesh | kur përdorimi është >1 l/sek. | 4 lek/$m^3$ |
| 30 | Përdorim burimi ujor nëntokësor për kërkime, studime, që kanë për objekt ujin | | 0 |
| 31 | Përdorim burimi ujor nëntokësor për kërkime, studime që nuk kanë për objekt ujin | | 0 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 32 | Përdorim burimi ujor nëntokësor e institucioneve monitoruese të ujërave sipërfaqësorë e nëntokësorë dhe institucioneve shkencore për kërkime, studime, eksplorime që ndikojnë në prishjen e ekuilibrave sasiorë dhe cilësorë të ujërave | | 0 |
| 33 | Përdorim burimi ujor për ndërtimin, rindërtimin, apo shembjen për mbrojtjen e brigjeve, mureve, pritave e veprave të tjera në brigje | | 0 |
| 34 | Përdorim burimi ujor për veprimtari ndërtimore në brigje | kur përdorimi është për sip. e strukturës ≤150 m$^2$ dhe ≤ se 5m hyrje në trupin ujor nga vija e bregut. | 0 |
| | | kur përdorimi është për sip. e strukturës >150 m$^2$ dhe > se 5 m hyrje në trupin ujor nga vija e bregut. | 0 |
| 35 | Përdorim burimi ujor për veprimtari mbrojtëse të përkohshme në rast emergjence | | 0 |
| 36 | Përdorim burimi ujor për ndërtimin e strukturave ankoruese, portuale dhe ishujve artificialë në det | | 0 |
| 37 | Shfrytëzimin e materialeve inerte që nxirren nga shtretërit e lumenjve, përrenjve, liqeneve me ose pa ujë | | 2% të vlerës së materialit të shitur |
| 38 | Përdorim burimi ujor për rehabilitimin e trupave ujorë nga bashkitë dhe institucionet publike që e kanë si funksion në fushën e përgjegjësisë | | 0 |
| 39 | Përdorim burimi ujor për veprimtari të tjera në brigjet dhe shtratin e burimit ujor | | 0 |
| 40 | Përdorim ose ripërdorim të ujërave të përdorura, përfshi aplikimin e tyre në tokë | | 0 |

TABELA NR. 2

| **Nr. rend.** | **Tipat e përdorimit të burimit ujor** | | **Tarifa e përdorimit** |
|---|---|---|---|
| 1 | Shkarkimi i ujërave të përdorur industrial | | 5 lek/m$^3$ |
| 2 | Shkarkimi i ujërave të ndotur | për sisteme me aglomerat nën 2000 p.e. | 5 lek/m$^3$ |
| | | për sisteme me aglomerat mbi 2000 p.e. | 4 lek/m$^3$ |
| 3 | Ripërdorim i ujërave të ndotur | | 0 |

| | | |
|---|---|---|
| 4 | Shkarkimi i lëngjeve që mund të shkaktojnë infiltrimin ose akumulimin me kohë në ujërat sipërfaqësorë, shtretërit natyrorë ose artificialë, shtresat ujëmbajtëse ose ujërat nëntokësorë | 5 lek/$m^3$ |